



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KOMUNA PISHAJ, GRAMSH
KRYETARI

Nr. 180 Prot.

Pishaj me 19/03/2013

KONTRATE PUNE
Per mbikeqyrien e punimeve
ne objektin
” NDERTIM KUZ FSHATI CEKIN LAGJIA
JUGORE + PJESERISHT LAGJIA VERIORE”

Lidhet sot me date 19/03/2013 kjo kontrate
midis paleve:

Kryetarit te Autoritetit Kontraktues, Kryetarit te Komunes Pishaj z. Estref ÇEKREZI
qe ne dispozitat e kesaj kontrate njihet me emertimin **Punedhenes**

DHE

Shoqerise ”M.A.K” Studio i pajisur me licencen profesionale nga MPTT, nr. MK.1811/1 date
06.02.2012 i ngarkuar me detyren e SUPERVIZORIT te punimeve ne objektin “Ndertim KUZ
Fshati Cekin Lagjia Jugore +Pjeserish Lagjia Veriore”
me urdherin date 19/03/2013, qe ne dispozitat e kesaj kontrate njihet me emertimin
Punemarres

Kjo kontrate mbeshtetet ne dispozitat e Ligjit Nr.792 date 12.07.1995 “Kodi i Punes
Republikes se Shqiperise”, Ligjit Nr.8402 dt.10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin
e punimeve te ndertimit”, neni 7 dhe UKM Nr.3 dt.15.02.2001 “Per mbikeqyrjen dhe
kolaudimin e punimeve te ndertimit”, kreu I.

NENI 1

Objekti i Kontrates

**Punemarresi do te kryeje detyren e mbikqyresit te punimeve, ne objektin Ndertim KUZ Fshati
Cekin Lagjia Jugore +Pjeserish Lagjia Veriore”**
, nga autoriteti kontraktues Komuna Pishaj . Kjo detyre ka per qellim kontrollin e
mbarevajtjes se te gjithë procesit te zbatimit te punimeve ne perputhje me projektin,
kushtet teknike te projektimit, te zbatimit, si dhe destinacionin e objektit, duke patur
parasysh dhe anen ekonomike te tij.
Punemarresi, ne cilesine e mbikqyresit te punimeve, eshte pergjegjes per sakesine,
vertetesine e dokumentave dhe cilesine e punimeve te ndertimit, ne objektin ne fjale.



NENI 2

Detyrat e Punemarresit

1. Mbikqyresi mban dhe pergjigjet per dokumentacionin e percaktuar ne pikat a, b, c, ç, d te nenit 4 te UKM Nr.3 dt.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", kreu I.

2. Ne castin e fillimit te punimeve mbikqyresi duhet te beje veprimet paraprake te percaktuara ne pikat a, b, c, ç, te nenit 5 te UKM Nr.3 dt.15.02.2001 "Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te ndertimit", kreu I.

3. Mbikqyresi ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose me shume punetoreve te sipermarresit, sipas percaktimeve ne piken 8 te UKM Nr.3 dt.15.02.2001.

4. Materialet qe vijne ne kantier duhet te jene ne perputhje me kerkesat teknike te projektit dhe duhet te perdoren vetem me miratimin e mbikqyresit. Mospranimi duhet te shoqerohet me proces-verbalet e analizave te provave, se bashku me aktin teknik ku te argumentohen shmangiet e palejuara, referuar standarteve te detyrueshme shqiptare dhe atyre europiane. Mbikqyresi ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materialeve te vendosura ne objekt per te ferifikuar cilesine, me shpenzimet sipermarresit.

5. Mbikqyresi ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet per zbatimin teknik te gabuar apo paaftesi teknike zbatimi, ne cdo rast me miratimin e investitorit, per aq kohe sa quhet e nevojeshme per korrigjimin e gjendjes.

6. Mbikqyresi kontrollon zbatimin e hollesishem te grafikut te punimeve dhe i raporton investitorit per realizimin e tij. Asnje punim nuk do te maskohet, mbulohet a betonohet pa miratimin e mbikqyresit te punimeve. Sipermarresi do te njoftoje mbikqyresin kur punimet jane gati per tu ekzaminuar prej tij.

7. Mbikqyresi mban dosjen e mbikqyrjes se punimeve ku perfshihet i gjithe dokumentacioni i percaktuar ne piken 14 te Nr.3 dt.15.02.2001.

8. Investitori mund te kerkoje largimin dhe zevendesimin e mbikqyresit kur verehen mangesi ne punen e tij si:

-Mangesi ne plotesimin e detyrave te percaktuara ne piken 1 te Nr.3 dt.15.02.2001.

-Nderprerje e paarsyshme e punimeve dhe zgjatje e theksuar e tyre.

-Mangesi kontrolli ne kosto e kontabilitet, tolerim i materialeve me vlere mbi ato te preventivuara ose jo me cilesi.

Ne rastin e nderrimit te mbikqyresit te punimeve procedohet sipas percaktimeve te bera ne piken 14 te Nr.3 dt.15.02.2001, paragrafi i trete.

9. Sipermarresi duhet te njoftoje me shkrim mbikqyresin per perfundimin e punimeve. Ne kete rast, brenda 30 diteve, ai i paraqet mbikqyresit dokumentacionin e percaktuar ne piken 15 te Nr.3 dt.15.02.2001.

10. Mbikqyresi merr pjese ne kolaudimin e vepres, i pergjigjet kolaudatorit me te gjithe dokumentacionin e nevojeshem per kolaudimin e vepres, si dhe firmos proces-verbalin e ketij kolaudimi.

11. Situacionet e paraqitura nga sipermarresi kontrolohen dhe miratohen nga mbikqyresi i punimeve. Pagesa mund te behet vetem ne baze te ketij miratimi, duke proceduar sipas percaktimeve te bera ne piken 17 te Nr.3 dt.15.02.2001.

12. Mbikqyresi i punimeve autorizon dhe kontrollon perdorimin e fondit rezerve te preventivuar dhe i raporton periodikisht investitorit per gjendjen e tij. Ky i fundit nese ka verejtje e njofton sipermarresin dhe problemi zgjidhet mes tyre. Per cdo ndryshim te



mundshem mbikqyresi i punimeve vihet ne dijeni per te ndjekur zbatimin e ndryshimeve ne fjale.

13. Kur verehen shkelje te renda te dispozitave ligjore investitori apo dikasteri epror, si dhe dega e Policise Ndertimore mund te urdherojne mbikqyresin per ndeprerjen e punimeve dhe marrjen e masave per normalizimin e gjendjes.

Mbikqyresi mban pergjigjesi administrative dhe penale per zbatimin e detyrave te tij.

Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundravajtje administrative vendosen sanksione ne baze te neneve 15 dhe 16 te kreu t III te Ligjit Nr.8402 dt.10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit".

14. Punemarresi (mbikqyresi i punimeve) kur te jete e nevojshme duhet tu jape zgjidhje problemeve te ndryshme, ne bashkepunim me punedhenesin.

NENI 3

Pagesa

Mbikqyresi i punimeve merr si shperblim per punen e kryer shumen _____ leke, ne perfundim te gjithe procesit te zbatimit te punimeve, kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te punimeve.

NENI 4

Zgjidhja e Kontrates

Zgjidhja e kontrates behet me:

-Marreveshje te paleve.

-Ne rastin e nderrimit te mbikqyresit nga investitori, panvaresisht nga vullneti i mbikqyresit.

-Mbarimin e te gjithe afateve te punimeve te kerkuara ne dispozitat ligjore dhe nenligjore perkatese.

NENI 5

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Per mosmarreveshjet qe lindin ndermjet Punedhenesit dhe Punemarresit, kur nuk kane qene e mundur te zgjidhen me mirekuptim ndermjet tyre, kompetente per zgjidhjen e tyre do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqsor Elbasan .

PUNEDHENESI

KRYETARI I KOMUNES PISHAJ

ESTREF ÇEKREZI



PUNEMARRESI

MBIKQYRESI I PUNIMEVE

"M.A.K" Studio

Ing Tomorr SPAHIU

